



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive	
Hjësia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	01
Nr. Prot. Dr. Prot. Prot. No:	950
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	2
Hyrëse	PRISHTINE/A
Data Datum Date: 15/05/2019	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**

*Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance*

*Zyra e Ministrisë / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister*

DATË/A:	15.05.2018
PËR/ZA/TO:	Ministrat, Kryetarët e Komunave, Udhëheqësit e Organizatave buxhetore, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Kryesor Financiar, Zyrtarët për buxhet të organizatave buxhetore
NGA/OD/FROM:	Bedri Hamza, Ministër i Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2019/01

Të nderuar,

Më lejoni t'ju falënderoj për kontributin e juaj në hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2019-2021, që paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2019.

Në vijim mund të gjeni Qarkoren Buxhetore 2019/01, e cila ofron kufijtë fillestar buxhetor për secilën Organizatë Buxhetore në nivel qendror për vitin 2019. Ministria e Financave mbetet në dispozicion të juaj për të ofruar mbështetjen e nevojshme gjatë procesit të hartimit të projektligjit të buxhetit për vitin 2019.

Me respekt!

Bedri Hamza  
Ministër i Financave



## **Qarkorja Buxhetore 2019/01**

### **1. Qëllimi**

Ministri për Financa është i autorizuar dhe përgjegjës që në përputhje me nenin 20 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048, të nxjerrë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e Buxhetit të Kosovës.

Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministri nxjerr Qarkoren e Parë Buxhetore 2019/01, ku ofrohen udhëzimet e para për hartimin e buxhetit për vitin 2019 dhe vlerësimet për vitet 2020-2021, kalendarin kohor indikativ si dhe kufijtë fillestar buxhetor për vitin 2019 dhe vlerësimet për vitet 2020-2021 për çdo Organizatë Buxhetore. Në rast nevojë, pas kësaj qarkoreje do të pasojnë qarkore të tjera shtesë deri në finalizimin e buxhetit për vitin 2019 dhe vlerësimet për vitet 2020-2021.

### **2. Konteksti për përgatitjen e buxhetit për 2019-2021**

Korniza për buxhetin e vitit 2019 bazohet në KASH 2019-2021 që është aprovuar nga Qeveria e Kosovës bazuar në prioritetet afatmesme të Qeverisë dhe kornizën makro-fiskale për vitet 2019-2021. Qeveria është e përkushtuar që duke ruajtur stabilitetin fiskal të përkrah kërkesat e organizatave buxhetore, brenda orientimit sektorial buxhetor të përcaktuar me KASH 2019-2021, sipas prioritetëve të përcaktuara përmes Deklaratës së Prioritetëve Afatmesme të Qeverisë.

Projeksionet fiskale të KASH 2019-2021 kanë përcaktuar burimet e financimit që Qeveria mund të ketë në dispozicion për shpenzim në vitin 2019, dhe vlerësimet e viteve vijuese. Çdo tejkalim i kufijve të shpenzimeve - përmbi kufijtë e kësaj qarkoreje - e bën të detyrueshëm ndryshimin rritjen e burimeve të financimit, gjegjësisht ndryshimin e politikave tatimore për të arkëtuar të hyra shtesë.

Gjatë zhvillimit të procesit buxhetor, duhet të marrim parasysh edhe zotimet tona në raport me institucionet financiare ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Qarkorja Buxhetore 2019/01 është hartuar në pajtim me obligimet nga marrëveshjet financiare ekzistuese dhe të atyre në negocim, dhe reflekton përkushtimet për drejtimin e politikave fiskale të përcaktuara në pajtim me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN).

### **3. Parashikimet për implementimin e buxhetit 2018**

Para prezantimit të kërkesave buxhetore për vitin 2019, organizatat buxhetore duhet t'i prezantojnë Ministrisë së Financave një parashikim të realizimit deri në fundvit të buxhetit të vitit 2018 në nivel të programeve, nën-programeve, dhe projekteve individuale. Organizatat buxhetore duhet të identifikojnë dhe të njoftojnë Ministrinë e Financave për nën apo mbi shpenzimet eventuale në buxhetin ekzistues, para parashtrimit të kërkesës buxhetore për vitin 2019, dhe vlerësimeve për 2019-2020.

#### 4. Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit për 2019-2021

Procesi buxhetor për vitet 2019-2021 ka për qëllim ndërlidhjen e planeve dhe politikave buxhetore të Qeverisë me nevojat ekonomike dhe sociale të vendit. Në nivel sektorial, kjo ndërlidhje është realizuar në prioritizimin e sektorëve buxhetor në KASH 2019-2021. Përmes kësaj qarkoreje, kërkohet që organizatat buxhetore të konkretizojnë kërkesat e prezantuara për KASH, duke detajuar kështu përgatitjen e buxhetit në nivel të programeve, nën-programeve, dhe projekteve individuale.

Kërkesat për shpenzime të reja duhet të prezantohen vetëm nëse të njëjtat janë përfshirë në KASH 2019-2021. Gjatë procesit buxhetor, Ministria e Financave duhet të sigurohet se totali i shpenzimeve për të gjitha organizatat brenda një sektori e përcjell shumën e paraparë me KASH 2019-2021 për këtë sektor.

Organizatat buxhetore duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së kërkesave të tyre t'u japin prioritet:

- Projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e prioriteteve të Qeverisë, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021,
- Projekteve të cilat janë në vazhdimësi nga vitet paraprake,
- Zotimet e Qeverisë për Planin e Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe programin – Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA),
- Legjislacioni i ri apo ndryshim plotësimi i atij ekzistues,
- Të përfshijnë brenda ndarjeve buxhetore obligimet për financim të jashtëm të projekteve individuale,
- Të kujdesen që të hyjnë në obligime për bashkëfinancim vetëm deri në nivelin që lejon korniza e tyre buxhetore.

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxheti në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale si dhe,
- Prezantimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2019 dhe projeksionet për vitet 2020-2021.

Qeveria mund të ndryshojë strukturën e shpenzimeve me qëllim të arritjes së prioriteteve të saj, si brenda programeve të një organizate buxhetore, ashtu edhe zhvendosjen e buxhetit nga një organizatë në tjetrën.

Kërkesat buxhetore duhet të mbështesin politikat prioritare të Qeverisë që lidhen me rritjen e qëndrueshme ekonomike, punësimit dhe mirëqenies, sundimi i ligjit, arsimit, shëndetësia dhe integritet evropiane.

**Shpenzimet rrjedhëse:** organizatat buxhetore duhet të bëjnë kërkesat e tyre përbrenda kufizimeve buxhetore. Është thelbësore që të gjitha organizatat buxhetore t'u përmbahen kufijve të dhënë në Shtojcën 1. të bashkangjitur, për vitet 2019-2021. Shpenzimet operative për vitin 2019 dhe vlerësimet për vitet 2020-2021 do të pësojnë ngritje të lehtë në krahasim me vitin 2018. Kjo rritje ka të bëjë kryesisht me përmirësimin e klasifikimit të shpenzimeve nga vitet e kaluara. Ministria e Financave është duke hartuar udhëzimin administrativ që ka

për qëllim përmirësimin e procesit të dhënies së arsyeshmërisë dhe lejimit të transfereve dhe rialokimeve.

**Punësimi:** Në parim nuk do të ketë rritje të punësimit në sektorin publik përveç kur ka një vendim të qartë për nevojën e punësimeve të reja, siç është rasti me shndërrimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës.

**Pagat dhe mëditjet:** kategoria e shpenzimeve për paga dhe mëditje historikisht ka përfaqësuar pjesën më të madhe të shpenzimeve rrjedhëse dhe gjithashtu planifikohet që përgjatë periudhës planifikuese trendi i njëjtë të vazhdojë. Përgjatë periudhës planifikuese, kjo kategori pritet të ngritet gradualisht, e ndikuar kryesisht nga alokimi i mjeteve për implementimin e pjesës së kontratës kolektive që ndërlidhet me përvojën e punës si dhe adresimin e pakos së reformës së administratës publike. Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me FMN-në ka formuluar dispozita të nevojshme ligjore që sigurojnë se ngritja e faturës së pagave në sektorin publik të jetë në harmoni me zhvillimin e gjithmbarshme ekonomike në vend.

**Mallra dhe shërbime:** me qëllim të racionalizimit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, si dhe përfshirjes së iniciativave të reja të cilat në vete bartin kosto shtesë për buxhetin, shpenzimet në këtë kategori janë planifikuar të mbajnë pjesëmarrjen e njëjtë në BPV me vitet paraprake. Si rrjedhojë, shpenzimet për këtë kategori pritet të shënojnë një ngritje rreth 9.85% në mesatare përgjatë periudhës planifikuese, si rezultat i implementimit të ndryshimeve ligjore të cilat bartin me vete kosto shtesë si dhe përmirësimin të klasifikimit të shpenzimeve nga vitet e kaluara.

**Shpenzimet komunale:** priten të ketë pjesëmarrje të njëjtë krahasuar me vitin 2018.

**Subvencionet dhe transferet:** si pjesëmarrësi i dytë më i lartë në kategorinë e shpenzimeve rrjedhëse, kjo komponentë planifikohet të shfaqë një rritje më të theksuar në vitin e parë të periudhës afatmesme, kurse në dy vitet e fundit të periudhës raportuese të ketë nivel më të ulët të rritjes me periudhat paraprake. Rrjedhimisht, shpenzimet për këtë kategori planifikohen të arrijnë në 584.1 milionë euro në fund të vitit 2021, shifër kjo e cila përfaqëson rritje prej rreth 11.1% nëse krahasohet me vitin 2018, me një pjesëmarrje prej 7.6% të BPV-së në mesatare. Në harmoni me planifikimet paraprake dhe me objektivat e Qeverisë për privatizim dhe stabilizimin e funksionimit të ndërmarrjeve publike, subvencionet për ndërmarrjet publike planifikohen të bien në vazhdimësi gjatë periudhës planifikuese.

**Shpenzimet kapitale:** përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale qeveritare në raport me të kaluarën. Shpenzimet kapitale përgjatë periudhës afatmesme pritet të përfaqësojnë rreth 35.1% të shpenzimeve totale apo një mesatare prej rreth 11.1% të BPV-së për periudhën 2019-2021. Gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, është i rëndësishëm implementimi i projekteve kapitale i bazuar në një listë prioritare që përmban projekte me ndikim në përmirësimin e rrjetit të transportit si dhe investimet në infrastrukturën e shërbimeve për përmirësimin e kushteve në arsim, sistemin social, shëndetësor dhe atë mjedisor. Rritja në mesatare për tre vitet e ardhshme llogaritet të jetë me një normë prej 7.9%.

Përparësi në financim do të kenë projektet që janë në vazhdim si dhe ato të cilat janë në harmoni të plotë me prioritetet e Qeverisë. Të gjitha projektet kapitale mbi një milion euro

duhet të përgatiten mbi bazën e analizës **kost-benefit**. Rrjedhimisht, kufijtë buxhetor për shpenzime kapitale nëpër organizata buxhetore janë indikativ dhe Qeveria mban të drejtën t'i ndryshojë ata varësisht nga arsyeshmëria e projekteve që propozohen nga organizatat buxhetore. Vlen të theksohet se Ministria e Financave është duke punuar në hartimin e udhëzimeve administrative të cilat kanë për qëllim përmirësimin e sistemit të menaxhimit të projekteve kapitale në vend, më saktësisht definimin e qartë të shpenzimeve kapitale dhe rrjedhëse në kuadër të shpenzimeve të projekteve kapitale si dhe kriteret përzgjedhëse dhe prioritetizimin e projekteve kapitale nga organizatat buxhetore.

## **5. Programi për investime publike (PIP)**

Planifikimi i buxhetit për investime kapitale bëhet përmes sistemit të PIP-it. Është e rëndësishme që prioritetet strategjike të Qeverisë, ashtu si janë paraqitur në “Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2019-2021” në kuadër të KASH-it 2019-2021 të jenë bazë për përgatiten e kërkesave buxhetore dhe identifikim të projekteve kapitale.

Të gjitha organizatat buxhetore duhet të arsyetojnë kërkesat buxhetore për projektet e tyre në përputhje të plotë me kërkesat e PIP-it.

## **6. Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit (SZHMB – BDMS)**

Siç është e njohur, Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit është sistem financiar i cili merret me formulimin e buxhetit dhe planifikimin e shpenzimeve për të gjitha kategoritë të shpenzimeve. Që tani Sistemi SZHMB është në dispozicion për shfrytëzim nga organizatat buxhetore. Organizatat Buxhetore janë të detyruara që të respektojnë kufijtë e lëshuar me Qarkoren e parë buxhetore. Sistemi i SZHMB dhe sistemi i PIP-it nuk do të lejojnë në asnjë rast tejkalim të kufijve të lëshuar me qarkoren e parë buxhetore.

## **7. Indikatorët e performancës**

Për secilin program organizatat buxhetore duhet të prezantojnë indikatorët e performancës të përmbledhur sipas objektivave që ka çdo Organizatë Buxhetore. Forma e ofrimit të këtyre informatave është dhënë në Aneksin 2. Në mënyrë specifike për secilin program duhet të ofrohen këto informata:

- Indikator i inputit/resurset e angazhuara;
- Indikator i produktit ('Output');
- Indikator i rezultatit ('Outcome');
- Indikator i efikasitetit për secilin produkt.

## **8. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator (BPGJ)**

Duke vepruar sipas Ligjit për Barazi Gjimore Nr.05/L-020 (2015), institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për "përfshirjen e buxhetimit gjinator në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjimore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve" (Neni 5.1.5.). Për këtë arsye, organizatat buxhetore duhet të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë gjimore në buxhetin vjetor për vitin 2019. Kjo do të kontribuon gjithashtu në rritjen e efektivitetit dhe transparencës së menaxhimit të financave publike. Komunitat duhet të marrin parasysh këto

udhëzime në nxjerrjen e qarkores së brendshme buxhetore komunale, si dokument bazë për planifikimin e buxhetit komunal për periudhën 2019-2021. Nëse ka paqartësi në këtë drejtim, organizatat buxhetore mund të konsultohen me analistët përkatës në kuadër të Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave (MF). Forma e ofrimit të këtyre informatave është dhënë në Aneksin 1.

## **9. Kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore të nivelit qendror për 2019-2021**

Organizatat Buxhetore të nivelit qendror duhet të marrin parasysh kufijtë buxhetore të dhënë në tabelën në vijim gjatë përgatitjes së buxhetit të tyre për 2019 dhe për dy vitet në vijim. Të keni parasysh se këta kufij buxhetor mund të ndryshojnë varësisht nga lëvizjet fiskale apo vendimet e Qeverisë të cilat do të pasqyrohen përmes Qarkoreve Buxhetore pasuese si dhe kualitetit të kërkesave buxhetore. Projektet kapitale të filluara nga vitet e kaluara, të cilat kanë krijuar obligime kontraktuale mbi mjetet e buxhetuara për organizatat buxhetore përkatës, duhet të përfshihen brenda buxhetit për vitet 2019-2021.

Kërkesa për buxhet nga organizata buxhetore të nivelit qendror duhet të përfshijnë:

- Një tabelë me parashikimet deri në fundvit të implementimin të buxhetit 2018, në nivel programi dhe nën-programi, si dhe komentet për përcjellëse për nën-ekzekutimin e apo nevojën për mbi-ekzekutim nga ndarjet e buxhetit 2018
- Formularët e PCF-ve të shtypura nga sistemi i BDMS-së,
- Formularët e shtypur nga Sistemi PIP dhe
- Letër kërkesa (shkresa përcjellëse) e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm apo Kryeshefi i agjencionit me të gjitha materialet buxhetore.
- Përshkrimi i kërkesës në formë narrative, ku do të paraqiten këto të dhëna:
  - Të arriturat deri më tani me fokus të veçantë në realizimin e objektivave të parapara në SKZH, PRE, PKZMSA
  - Çfarë synohet të arrihet me ndarjet buxhetore për vitin 2019 dhe vlerësimet për vitet 2020-2021.
  - Organizatat buxhetore duhet të njoftojnë Ministrinë e Financave nëse kërkesa buxhetore mbulon vazhdimin e politikave ekzistuese, apo parasheh përfundimin e aktiviteteve vijuese dhe fillimin e aktiviteteve të reja
  - Për aktivitetet e reja, organizatat buxhetore duhet të shënojnë bazën ligjore (koncept dokument, udhëzim administrativ, projektligj, etj.), dhe të njoftojnë nëse për këtë bazë ligjore është kryer Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor, në pajtim me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 03/2015 për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor për Nismat e Reja Qeveritare.

Më poshtë në Tabelën 1 janë kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore qendrore për 2019-2021:

Kodi org.	Ministritë/Institucionet	Kufiri i buxhetit për vitin 2019								Vlerësimet për vitin 2020			Vlerësimet për vitin 2021		
		Nr. i punëtorëve	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe Shërbime	Shpenzimet Komunale	Subvencione dhe Transfere	Shpenzimet Kapitale	Rezerva	Total 2019	Shpenzime Operative	Shpenzime Kapitale	Total 2020	Shpenzime Operative	Shpenzime Kapitale	Total 2021
101	Kuvendi i Kosovës	394	7,062,430	2,112,000	241,000	140,000	1,190,000	-	10,745,430	9,590,742	1,190,000	10,780,742	9,626,231	1,190,000	10,816,231
102	Zyra e Presidentit	80	1,069,068	1,902,421	6,700	270,000	15,000	-	3,263,189	3,253,534	15,000	3,268,534	3,258,906	15,000	3,273,906
104	Zyra e Kryeministrit	603	4,245,053	9,349,108	143,248	1,995,000	290,000	-	16,022,409	16,003,634	694,000	16,697,634	16,524,965	424,000	16,948,965
201	Ministria e Financave	1,801	24,166,733	10,259,866	538,592	8,826,000	24,364,754	-	68,155,945	71,109,028	14,888,000	85,997,028	101,407,451	12,388,000	113,795,451
202	Ministria e Administrimit Publik	277	2,172,960	6,762,352	2,949,600	-	11,338,000	-	23,222,912	11,895,777	11,093,000	22,988,777	12,438,197	10,093,000	22,531,197
203	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	398	2,575,199	3,363,681	135,660	47,477,022	6,400,000	-	59,951,562	53,564,438	6,399,800	59,964,238	53,577,379	6,400,000	59,977,379
204	Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë	248	1,690,365	2,185,254	109,280	2,050,000	3,855,492	-	9,890,391	6,043,351	5,133,238	11,176,589	6,051,845	6,200,000	12,251,845
205	Ministria e Infrastrukturës	298	1,883,977	8,103,323	375,190	1,443,814	311,215,500	-	323,021,804	11,815,724	329,900,000	341,715,724	11,825,191	322,500,000	334,325,191
206	Ministria e Shëndetësisë	1,158	7,823,676	36,870,363	230,548	7,913,805	18,650,000	-	71,488,392	65,877,510	14,200,000	80,077,510	78,916,824	12,300,000	91,216,824
220	Sherbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosoves	7,228	57,252,238	11,863,909	3,603,416	-	10,520,000	-	83,239,563	73,005,824	10,520,000	83,525,824	73,293,517	9,300,000	82,593,517
207	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	775	4,511,282	1,280,986	404,908	8,516,550	26,500,000	-	41,213,726	15,736,283	26,007,428	41,743,711	16,758,952	26,537,428	43,296,380
208	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	2,146	18,803,791	16,156,888	1,616,459	5,041,929	24,975,485	-	66,594,551	43,713,085	25,355,678	69,068,763	48,307,574	25,570,000	73,877,574
209	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	855	5,220,919	1,844,251	377,085	426,179,207	1,920,000	-	435,541,462	438,719,279	1,480,000	440,199,279	443,745,514	1,485,000	445,230,514
210	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	343	2,273,927	1,418,081	83,220	-	70,250,000	-	74,025,228	3,786,597	95,340,320	99,126,917	3,798,024	101,340,320	105,138,344
211	Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit	120	799,980	376,652	17,000	300,000	7,000,000	-	8,493,632	1,499,132	8,000,000	9,499,132	1,504,000	9,000,000	10,504,000
212	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	154	1,003,876	264,431	15,500	50,000	11,250,000	-	12,583,807	1,338,827	27,350,000	28,688,827	1,343,871	28,350,000	29,693,871
213	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	175	1,209,712	4,463,669	46,210	12,368,870	22,640,000	-	40,728,461	22,094,510	18,540,000	40,634,510	24,100,589	16,540,000	40,640,589
214	Ministria e Punëve të Brendshme	10,568	79,334,796	23,298,194	1,981,800	3,044,367	16,387,037	-	124,046,193	108,042,830	25,469,850	133,512,680	111,441,488	29,769,850	141,211,338
215	Ministria e Drejtësisë	2,069	13,786,193	5,168,899	1,063,169	1,928,000	1,355,000	-	23,301,261	23,379,192	1,705,000	25,084,192	25,548,468	1,005,000	26,553,468
216	Ministria e Punëve të Jashtme	309	6,889,118	16,953,547	588,051	100,000	6,555,000	-	31,085,716	24,715,161	6,555,000	31,270,161	24,949,779	5,555,000	30,504,779
217	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	3,480	23,559,849	12,202,345	950,000	-	20,208,966	-	56,921,160	38,573,818	23,190,704	61,764,522	40,925,163	25,690,704	66,615,867
218	Ministria për Integritet Evropian	96	701,320	970,962	10,000	515,000	-	-	2,197,282	2,200,789	-	2,200,789	2,189,313	-	2,189,313
219	Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike	82	607,402	1,269,712	14,500	130,000	-	-	2,021,614	2,024,651	-	2,024,651	2,027,703	-	2,027,703
222	Ministria e Zhvillimit Rajonal	54	375,819	350,000	11,360	1,500,000	2,000,000	-	4,237,179	2,265,026	2,000,000	4,265,026	2,294,586	2,000,000	4,294,586
220	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë	52	354,520	385,000	23,000	7,150,000	3,000,000	-	10,912,520	7,914,293	4,000,000	11,914,293	7,916,074	4,000,000	11,916,074
230	Komisioni i Rregullativ i Prokurimit Publik	42	372,623	269,253	5,000	-	150,000	-	796,876	648,739	150,000	798,739	650,611	150,000	800,611
231	Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës	55	864,684	384,943	5,000	-	-	-	1,254,627	1,258,951	-	1,258,951	1,263,296	-	1,263,296
235	Autoriteti i Rregullatorit i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	39	441,976	355,232	14,700	-	700,000	-	1,511,908	814,118	800,000	1,614,118	816,339	800,000	1,616,339
236	Agjencioni Kundër-Korrupsion	40	378,635	138,908	8,500	-	-	-	526,043	527,936	-	527,936	529,839	-	529,839
238	Zyra Rregullatorit për Energji	33	494,657	199,332	22,000	-	72,000	-	787,989	718,462	72,000	790,462	720,947	70,800	791,747
240	Organi Shqyrtues i Prokurimit	23	220,864	114,355	5,100	-	-	-	340,319	341,423	-	341,423	342,533	-	342,533
241	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	26	200,826	153,109	10,000	-	-	-	363,935	364,939	-	364,939	365,948	-	365,948
242	Univerziteti i Prishtinës	2,081	21,263,857	3,402,645	1,175,000	1,299,000	7,900,000	-	35,040,502	27,246,822	7,900,000	35,146,822	27,353,673	7,900,000	35,253,673
243	Gjykata Kushtetuese e Kosoves	70	1,187,745	491,702	4,000	-	185,000	-	1,868,447	1,689,386	185,000	1,874,386	1,695,354	185,000	1,880,354
244	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	25	260,846	66,861	14,000	-	-	-	341,707	343,011	-	343,011	343,461	-	343,461
245	Agjencioni Kosovar i Inteligjencës	105	3,752,352	1,820,282	40,000	500,000	2,000,000	-	8,112,634	6,231,396	2,000,000	8,231,396	6,250,252	2,000,000	8,250,252
246	Këshilli i Kosovës për Trashigimni Kulturorë	16	130,972	87,993	2,550	-	-	-	221,515	222,169	-	222,169	222,828	-	222,828
247	Paneli Zgjedhor për Anketa dhe Parashtesa	20	137,155	73,613	7,820	-	-	-	218,588	219,274	-	219,274	219,963	-	219,963
249	Këshilli i Pavarur Mbiqyrtës për Sherbimin Civil të Kosovës	28	260,777	117,358	3,825	-	-	-	381,960	383,264	-	383,264	384,575	-	384,575
250	Keshilli Prokurororial i Kosoves	846	7,896,462	2,470,552	199,630	-	1,784,500	-	12,351,144	10,206,126	1,834,500	12,040,626	11,245,806	1,884,500	13,130,306
302	Zyra Kombetare e Auditimit	167	2,029,692	651,289	45,000	-	60,000	-	2,785,981	2,736,129	60,000	2,796,129	2,746,329	60,000	2,806,329
313	Autoriteti Rregullativ i Sherbimeve të Ujit	21	251,373	134,495	6,503	-	-	-	392,371	393,627	-	393,627	394,891	-	394,891
314	Autoriteti Rregullativ i Hekurdhhave	25	215,545	167,179	6,400	-	-	-	389,124	390,202	-	390,202	391,285	-	391,285
317	Autoriteti i Aviacionit Civil	30	720,446	223,052	13,738	-	-	-	957,236	960,839	-	960,839	964,459	-	964,459
318	Komisioni i Pavarur i Minerave dhe Mineraleve	77	819,725	386,281	30,600	-	9,000	-	1,245,606	1,240,704	9,000	1,249,704	1,244,824	9,000	1,253,824
319	Komisioni i Pavarur i Mediave	37	452,591	365,383	28,000	-	-	-	845,974	848,237	-	848,237	850,511	-	850,511
320	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	88	791,853	436,269	70,710	4,200,000	60,000	-	5,558,832	5,544,696	48,900	5,593,596	11,612,821	-	11,612,821
321	Institucioni i Avokatit të Popullit	78	962,101	324,353	25,500	-	33,000	-	1,344,954	1,336,764	33,000	1,369,764	1,341,599	33,000	1,374,599
322	Akademia e Drejtësisë	28	232,409	575,400	14,500	-	13,000	-	835,309	823,471	1,013,000	1,836,471	824,639	1,013,000	1,837,639
328	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	2,271	18,027,657	4,360,425	450,000	350,000	895,000	-	24,083,082	24,278,220	895,000	25,173,220	27,368,809	895,000	28,263,809
329	Agjencia Kosovare ipër krahasim dhe Verifikim të Pronës	242	1,236,593	1,163,645	88,523	-	402,000	-	2,890,761	2,494,944	90,000	2,584,944	2,501,158	70,000	2,571,158
251	Agjensioni Shtetëror për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	24	228,305	130,448	6,450	-	-	-	365,203	366,344	-	366,344	367,492	-	367,492
253	Agjencioni për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale	12	94,902	74,871	30,000	-	5,500,000	-	5,699,773	200,247	6,250,000	6,450,247	200,724	5,350,000	5,550,724
232	Shpenzimet e Paparashikuara						2,000,000	4,800,000	6,800,000	4,800,000	2,000,000	6,800,000	4,800,000	2,000,000	6,800,000
248	Radio Televizioni i Kosoves		-	-	-	11,200,000	-	-	11,200,000	11,200,000	-	11,200,000	11,200,000	-	11,200,000
	<b>Totali</b>	<b>40,312</b>	<b>333,301,824</b>	<b>198,315,121</b>	<b>17,868,545</b>	<b>554,488,564</b>	<b>623,643,734</b>	<b>4,800,000</b>	<b>1,732,417,788</b>	<b>1,166,993,478</b>	<b>682,367,418</b>	<b>1,849,360,896</b>	<b>1,242,986,567</b>	<b>680,073,602</b>	<b>1,923,060,169</b>
239	Agjencioni Kosovar i Privatizimit	258	4,925,421	2,714,000	98,000	40,000	90,000	-	7,867,421	7,666,048	80,000	7,746,048	7,580,798	70,000	7,650,798
254	Agjencioni për Shërbimet e Navigimit Ajror	166	2,552,286	810,000	94,500	-	2,080,000	-	5,536,786	3,469,547	2,090,000	5,559,547	3,482,373	2,090,000	5,572,373
	<b>Totali i përgjithshëm me AKP dhe ASHNA</b>	<b>40,736</b>	<b>340,779,530</b>	<b>201,839,121</b>	<b>18,061,045</b>	<b>554,528,564</b>	<b>625,813,734</b>	<b>4,800,000</b>	<b>1,745,821,994</b>	<b>1,178,129,073</b>	<b>684,537,418</b>	<b>1,862,666,491</b>	<b>1,254,049,737</b>	<b>682,233,602</b>	<b>1,936,283,339</b>

## **1. Buxheti Komunal 2019-2021**

### **1.1. Baza ligjore dhe parimet e financimit komunal**

Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e garantëve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2019 bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). Kufijtë e financimit për komunat për periudhën 2019-2021 janë aprovuar nga Komisioni i Garantëve me datë 12 prill 2018 si pjesë integrale e KASH 2019-2021 aprovuar në Qeveri me datë 27 prill 2018.

Komunat janë të obliguara të përgatisin Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2019-2021, si dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal, i cili pasqyron caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive të shpenzimeve, për të përmbushur objektivat e përcaktuara me strategjinë zhvillimore afatmesme komunale. Kuvendi Komunal shqyrton dhe aprovon Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB), e publikon në faqen zyrtare të komunës dhe një kopje dorëzohet në Departamentin e Buxhetit në MF deri me datë 30.06.2018.

Të gjitha Komunat të cilat parashikojnë që gjatë vitit 2019 të financojnë projekte përmes emetimit të instrumenteve financiare/huamarrjes shtetërore komunale ose garancive komunale, duhet paraprakisht të ju nënshtrohen dispozitave ligjore përkatëse të përcaktuara me LMFPP gjegjësisht Pjesa IX, Ligjit për Borxhin Publik Nr. 03/L -175 Pjesa II -Huamarrja Komunale, si dhe Rregullores QRK nr. 22/2013 Mbi Procedurat për Emetimin dhe Menaxhimin e Borxheve Shtetërore, Garancive shtetërore dhe Borxheve komunale, gjegjësisht Nenit 9 dhe 10.

## **2. Burimet e Financimit Komunal për vitin 2019-2021**

### **2.1. *Granti i Përgjithshëm***

Bazuar në Tabelën 1, të paraqitur në vijim, të përgatitur nga Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar të Ministrisë së Financave në përputhje me LFPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2019 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 180.69 milion euro.

Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave, duke përjashtuar: mbështetjen buxhetore dhe grantet, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat e njehershme nga borxhet, të hyrat e dedikuara, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale.

Siç paraqitet në tabelën në vijim, bazuar në vlerësimet e Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar, të hyrat e përgjithshme qeveritare për vitin 2019 pritet të jenë 1,920.3 milion euro. Nga kjo shumë, zbriten ato të hyra siç specifikohet në nenin 24 të LFPL dhe vijmë tek baza për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna, i cili grant për vitin 2019 është në shumë prej 180.69 milion euro.



Tabela 1: Përcaktimi i vlerës së Grantit të Përgjithshëm për komuna 2019-2021 (mil. Euro)

Përshkrimi	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
A. Të hyrat e përgjithshme të Qeverisë	1,644.00	1,896.00	1,920.3	2,029.7	2,149.9
Zbriten:					
Të hyrat e dedikuara	-45	-50	-9.2	-9.2	-9.2
Mbeshtetja buxhetore dhe grante	-1	-5	-5	-5	-5
Tatimi në pronë	-25	-30	-30	-33	-36
Të hyrat nga dividenda	-15	-5			
Grantet e percaktuara të donatorëve	-12	-12			
Taksa ngarkesa dhe të tjera nga Qeveria Lokale	-54	-52	-57	-57	-57
Të hyrat e njëhershme nga borxhet		-6	-8	-8	-4
Të hyrat nga interesi			-4.2	-4.2	-4.2
B. Baza për llogaritjen e grantit të përgjithshëm për komuna	1,492	1,736	1,806.9	1,913.3	2,034.5
C. Granti i përgjithshëm për komuna (10% e B)	149.2	173.6	180.69	191.33	203.45

Me amendamentin e fundit të LFPL, të aprovuar në Kuvendin e Kosovës më datë 14 korrik 2016, është bërë korrektimi i formulës së grantit të përgjithshëm. Pjesa prej 2.7% e grantit të përgjithshëm shpërndahet për 14 komuna që kanë numër të popullsisë nën 22,000 banorë. Nga kjo shumë, gjysma ndahet për këto 14 komuna bazuar në numrin e banorëve që kanë dhe gjysma tjetër ndahet si shumë fikse e njëjtë për secilën nga këto komuna.

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komuna me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë (3%); (iv) komuna ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me dy përqind (2%).

Tabela 2: Struktura e Grantit të Përgjithshëm për 2019-2021 sipas LFPL (mil. Euro)

Faktorët	2017	2018	2019	2020	2021
	Vlerësimi	Vlerësimi	Vlerësimi	Vlerësimi	Vlerësimi
Granti i përgjithshëm	149.2	173.6	180.69	191.33	203.45
Kontigjenca për korrektim të formulës (2.7%)	4	4.7	4.9		
Shuma Fikse	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6
Popullsia (banorë)	1,780,021	1,780,021	1,780,021	1,780,021	1,780,021
Buxheti: 89% e shumës agregate	125.99	147.1	153.3	167.0	177.8
Zona komunale (km2)	10,901	10,901	10,901	10,901	10,901
Buxheti: 6% e shumës agregate	8.5	9.92	10.33	11.26	11.99
Komunitetet pakicë në komunë	107,926	107,926	107,926	107,926	107,926
Buxheti: 3% e shumës agregate	4.3	5.0	5.2	5.6	6.0
Popullsia e komunave pakicë	62,031	62,031	62,031	62,031	62,031
Buxhti: 2% e shumës agregate	2.8	3.3	3.4	3.8	4.0

Tabela 3 në vijim paraqet shpërndarjen e Grantit të Përgjithshëm nëpër komuna sipas formulës të paraparë në LFPL.

Tabela 3: Shpërndarja e Grantit të Përgjithshëm nëpër komuna 2019-2021

**Formula e ndarjës së Grantit të Përgjithshëm për vitin 2019-2021**

Kategorija	Vrij 2019	Vrij 2020	Vrij 2021
Te izjave o Bandićevim izjavama i poslovima (otf)	1.806,9	1.913,3	2.024,2
Članici Vrhovnog suda (19%)	10%	180.690,000	203.450,000
Konjugalni peč, koristolici i formalis	2.7%	4.878,630	
Članici Vrhovnog suda		175.811,370	203.450,000
Štampa Hrvatske	140,000	3.656,657	3.656,657
Glasovi		172.174.713	199.813.433
Populacija	89%	153.265.405	167.047.075
Maternica i geografije	69%	10.330.483	11.120.401
Populacija Paketi	3%	5.166.241	5.610.800
Komuniste i Populacija Paketi	2%	3.441.404	3.725.867
			3.996.202

Rezultate për madhësinë e Grantit të Përfundimshëm (sipas LPT)										Granti i Përfundimshëm për vitin 2019				Granti i Përfundimshëm për vitin 2020				Granti i Përfundimshëm për vitin 2021			
Komunitet	Popullsia		Madhësia gjeografike		Popullsia në pikë		Komunitet në pikë		Korrigjimi për korrelimin e formës	Korrigjimi për korrelimin e formës		Shuma e Shumës së Popullsisë (89%)	Shuma për madhësinë gjeografike (6%)	Shuma për popullsinë (3%)	Shuma për popullsinë dhe madhësinë gjeografike (2%)	Granti i përfundimshëm për vitin 2019	Granti i përfundimshëm për vitin 2020	Granti i përfundimshëm për vitin 2021			
	Popullsia	89%	Madhësia gjeografike	6%	Popullsia në pikë	3%	Komunitet në pikë	2%		Shuma e korrigjimit të formës	Shuma e korrigjimit të formës për 14 komunitet								Proportionaliteti sipas popullsisë për 14 komunitet	Granti (140,000-10)	
11 Durrës	48019	2.22%	297	2.72%	551	0.51%	000%	000%	-	-	-	99281	3,485,690	281,479	26,370	-	3,882,920	4,191,183	4,485,366		
2 Durrës	33997	1.91%	430	3.94%	13,659	12.96%	000%	000%	-	-	-	100003	2,026,677	407,523	468,022	-	4,089,125	4,498,136	4,728,522		
3 Fier	108610	6.10%	345	3.17%	4,953	3.89%	000%	000%	-	-	-	31,390	9,349,837	335,691	200,073	-	9,988,807	10,799,157	11,491,468		
4 Fier	34827	1.96%	83	0.76%	4,511	4.18%	000%	000%	-	-	-	105145	2,988,129	78,282	215,892	-	3,397,977	3,694,767	3,926,595		
5 Gjirokastra	94556	5.31%	587	5.39%	6,629	6.19%	000%	000%	-	-	-	45444	8,199,880	556,623	319,651	-	9,061,498	9,874,142	10,508,815		
6 Gjirokastra	90178	5.07%	392	3.69%	2,364	2.10%	000%	000%	-	-	-	46922	7,763,049	371,621	108,353	-	8,292,890	9,045,863	9,616,125		
7 Gjirokastra	58331	3.29%	276	2.59%	45	0.04%	000%	000%	-	-	-	81,669	5,088,720	261,688	2154	-	5,384,031	5,861,367	6,258,233		
8 Gjirokastra	9403	0.53%	83	0.76%	44	0.04%	000%	000%	-	-	-	130,997	809,423	78,282	2106	-	1,394,122	1,401,206	1,416,881		
9 Gjirokastra	39,889	2.21%	454	4.17%	3,085	2.89%	000%	000%	-	-	-	100,711	3,382,346	430,739	147,665	-	4,000,981	4,417,933	4,696,710		
10 Kukës	684	0.34%	74	0.68%	4	0.00%	000%	000%	-	-	-	133,916	523,749	70,253	191	-	1,331,040	781,661	823,494		
11 Kukës	33,400	1.88%	211	1.96%	36	0.03%	000%	000%	-	-	-	106,991	2,656,690	290,888	1,723	-	3,061,878	3,678,540	3,961,878		
12 Korçë	34,885	2.03%	434	3.89%	1,984	1.72%	000%	000%	-	-	-	103,915	3,064,426	401,948	89,239	-	3,701,498	4,025,789	4,279,066		
13 Kukës	38,966	2.07%	309	2.84%	1,311	1.19%	000%	000%	-	-	-	101,504	3,313,980	290,962	59,893	-	3,767,889	4,086,297	4,358,484		
14 Lezë	4,999	0.26%	539	4.99%	323	0.30%	000%	000%	-	-	-	126,227	1,885,667	202,833	15,983	-	3,008,478	3,826,086	4,004,428		
15 Lezë	57,065	3.24%	338	3.10%	3,107	2.88%	000%	000%	-	-	-	82,395	4,959,004	330,466	148,686	-	5,510,543	5,999,798	6,381,905		
16 Maleshëve	54,613	3.07%	306	2.81%	54	0.05%	000%	000%	-	-	-	85,387	4,701,433	290,119	2,384	-	5,897,534	6,589,126	6,829,661		
17 Mamurras	5507	0.31%	32	0.29%	399	0.38%	000%	000%	-	-	-	134,693	4,774,077	30,650	18,139	-	3,067,707	3,125,409	3,108,842		
18 Mat	71,900	4.04%	331	3.04%	2,199	2.04%	000%	000%	-	-	-	68,991	6,930,382	313,832	79,548	-	6,677,538	7,273,266	7,738,518		
19 Novo Bredë	6,729	0.38%	204	1.87%	3,320	2.97%	000%	000%	-	-	-	133,271	579,275	193,454	153,245	-	1,375,841	1,442,706	1,507,888		
20 Oshin	21,549	1.21%	105	0.90%	1,665	1.58%	000%	000%	-	-	-	118,851	1,855,075	99,602	79,207	-	2,782,493	2,935,687	3,084,681		
21 Përre	96,950	5.42%	603	5.59%	8,344	7.72%	000%	000%	-	-	-	43,550	8,303,028	571,586	386,585	-	9,317,021	10,152,387	10,856,661		
22 Përre	88,990	4.97%	633	5.81%	8,830	8.09%	000%	000%	-	-	-	43,550	7,618,555	600,017	40,632	-	8,310,765	9,065,133	9,638,628		
23 Përre	108,897	11.17%	514	4.72%	4,166	3.84%	000%	000%	-	-	-	51,930	17,122,315	487,241	198,424	-	17,807,980	19,413,067	20,666,635		
24 Përre	177,781	9.93%	603	5.59%	31,682	29.30%	000%	000%	-	-	-	15,904,516	571,586	1,516,272	-	17,292,574	18,860,041	19,860,041			
25 Përre	36,308	3.16%	278	2.59%	941	0.87%	000%	000%	-	-	-	83,702	4,638,741	263,584	45,179	-	5,231,286	5,695,266	6,057,607		
26 Përre	6,690	0.39%	248	2.28%	3,382	2.99%	000%	000%	-	-	-	133,051	986,214	127,115	152,288	-	1,439,925	1,507,545	1,576,929		
27 Përre	27,524	1.54%	134	1.29%	888	0.79%	000%	000%	-	-	-	112,676	2,282,322	127,115	41,663	-	2,633,077	2,864,269	3,037,606		
28 Shkëlqim	8,685	2.86%	574	3.43%	109	0.10%	000%	000%	-	-	-	89,142	4,788,199	354,565	52,17	-	4,827,101	5,254,147	5,587,609		
29 Shkëlqim	39,722	3.36%	361	3.31%	575	0.53%	000%	000%	-	-	-	80,278	5,141,488	342,243	27,519	-	5,591,288	6,075,952	6,478,008		
30 Viti	46,887	2.64%	288	2.48%	288	0.24%	000%	000%	-	-	-	99,013	4,044,039	256,002	12,348	-	4,406,302	4,705,014	4,970,336		
31 Viti	69,870	3.59%	345	3.17%	900	0.89%	000%	000%	-	-	-	70,330	6,014,833	327,080	45,945	-	6,648,007	7,083,766	7,483,431		
32 Zallë	3,009	0.17%	333	3.00%	995	0.92%	000%	000%	-	-	-	130,969	314,205	314,205	367,271	-	1,474,734	1,480,715	1,480,715		
33 Zallë	7,881	0.43%	123	1.13%	386	0.36%	000%	000%	-	-	-	133,384	999,457	315,077	47,020	-	1,618,727	1,654,641	1,684,744		
34 Zallë	10,075	0.61%	131	1.20%	3,423	3.12%	000%	000%	-	-	-	133,384	999,457	315,077	47,020	-	1,618,727	1,654,641	1,684,744		
35 Zallë	2,556	0.14%	23	0.21%	1,193	1.17%	000%	000%	-	-	-	133,384	999,457	315,077	47,020	-	1,618,727	1,654,641	1,684,744		
36 Zallë	12,336	0.69%	5	0.09%	887	0.88%	12,336	19,877	12,336	19,877	12,336	17,754	1,611,100	4,862	41,949	684,237	2,254,383	2,080,868	2,206,995		
37 Përre	1,787	0.27%	29	0.27%	2	0.00%	2,884	2,884	1,787	17,871	37,896	18,213	153,836	27,066	96	99,201	630,995	444,256	460,418		
38 Shkëlqim	3,866	0.10%	69	0.63%	168	0.16%	3,866	6,23%	3,866	174,227	81,789	256,026	130,134	65,344	8,000	214,611	1,013,136	813,880	856,739		
TOTAL	1,780,021	100%	10,901	100%	107,926	100%	62,031	62,031	115,301	2,439,315	2,439,315	3,636,657	153,238,495	10,330,483	5,165,241	3,443,494	180,090,000	191,330,000	203,450,000		

Financimi i shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar nga MPMS në komuna përfshihet në kuadër të grantit të përgjithshëm të komunës.

Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim parauniversitar dhe Shëndetësi primare financohen nga granti i përgjithshëm në komuna.

Po ashtu, nga granti i përgjithshëm do të plotësohen edhe grantet specifike për arsim dhe shëndetësi kur është e nevojshme.

## **2.2. Granti specifik për Arsim parauniversitar**

Granti specifik për arsim parauniversitar për vitin 2019 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 185 milion euro, nga të cilat 183.5 milion euro janë grant bazë dhe 1.5 milion euro politika të reja. Granti Specifik për Arsim sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit parauniversitar të MASHT për vitin 2019.

Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kriterë:

- a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2017/2018;
- b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr.22/2013 të MASHT);
- c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
- d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
